paragrafi 2 i këtij neni, inspektorët kompetentë marrin masat e duhura të përkohshme për të ndaluar ose kufizuar vënien të produktit në dispozicion në tregun e Republikës së Kosovës, tërheqin produktin nga tregu ose siguroni kthimin nga përdoruesi.	stava 2. ovog člana, nadležni inspektori preduzimaju odgovarajuće privremene mere da bi zaustavili ili ograničili stavljanje proizvoda na raspolaganju na tržište Republike Kosovo, povlače proizvod sa tržišta ili obezbede povratak od korisnika.	from paragraph 2 of this Article, the competent inspectors shall take appropriate interim measures to stop or limit making such product available on the market of the Republic of Kosovo, withdraw the product from the market or ensure the return by the user.
6. Informacioni për masat përfshin të gjitha detajet e disponueshme, veçanërisht të dhënat e nevojshme për identifikimin e produktit që nuk përputhet, origjinën e produktit, llojin e mospërputhshmërisë së pretenduar dhe rrezikun e përfshirë, llojin dhe kohëzgjatjen e masave të marra dhe argumentet e paraqitura nga operatori ekonomik përkatës.	6. Informacija o merama uključuje sve raspoložive detalje, posebno podatke potrebne za identifikaciju proizvoda koji se neusklađuje, poreklo proizvoda, vrstu nastojaće neusklađenosti i uključenu opasnost, vrstu i trajanje preduzetih mera i predstavljeni argumenti od odgovarajućeg ekonomskog operatora.	6. The information on the measures shall include all available details, in particular the data necessary to identify the non-conforming product, the origin of the product, the type of non-conformity claimed and the hazard involved, the type and duration of the measures taken and the arguments presented by the relevant economic operator.
7. Inspektorati kompetent tregon në mënyrë specifike nëse mospërputhja është rezultat i shkaqeve të mëposhtme: 7.1. produkti nuk plotëson kërkesat në lidhje me shëndetin dhe sigurinë e personave ose mbrojtjen e kafshëve shtëpiake ose pronës; ose 7.2. ka mangësi në standardet e harmonizuara sipas neni 13 i kësaj Rregullore në lidhje me prezumimin e konformitetit.	7. Nadležni inspektorat na specifičan način ukazuje da li je neusklađenost rezultat sledećih uzroka: 7.1. proizvod ne ispunjava zahteve u vezi sa zdravljem i bezbednošću lica ili zaštitom domaćih životinja ili imovine; ili 7.2. ima nedostatke u harmonizovanim standardima prema članu 13 ove Uredbe u vezi sa pretpostavkom usaglašenosti.	7. The competent inspectorate shall indicate specifically if the non-compliance results from the following causes: 7.1. the product fails to meet the requirements regarding the health and safety of persons or the protection of domestic animals or property; or 7.2. There are deficiencies in the harmonized standards according to Article 13 of this Regulation regarding the presumption of conformity.

Neni 30 Klauzola mbrojtëse në lidhje me produktet të përputhshme të cilat paraqesin rrezik	Član 30 Zaštitne klauzule u vezi sa usklađenim proizvodima koji predstavljaju opasnost	Article 30 Protective clauses regarding hazardous compatible products
1. Kur inspektorati kompetent, pas kryerjes së një vlerësimi në përputhje me nenin 31, paragrafi 1 të kësaj Rregullore, konstatojnë se produkti, edhe pse është në përputhje me këtë Rregullore, ende paraqet rrezik për shëndetin dhe sigurinë e personave ose ndaj kafshëve shtëpiake ose pronës, kërkojnë nga operatori ekonomik marrjen e masave të duhura në mënyrë që produkti të mos jetë më i rrezikshëm pas vendosjes në treg, ata kërkojnë tërheqjen nga tregu ose sigurojnë kthimin nga përdoruesi brenda një kohe të arsyeshme, për të cilën ata vendosin në bazë të llojit të rrezikut.	1. Kada nadležni inspektorat, nakon izvršenja ocenjivanja u skladu sa članom 31, stav 1. ove Uredbe, utvrde da proizvod, iako je u skladu sa ovom Uredbom, i dalje predstavlja opasnost za zdravlje i bezbednost lica ili prema domaćim životinjama ili imovinu, zahtevaju od ekonomskog operatora preduzimanje odgovarajućih mera kako proizvod više ne bi bio opasan nakon stavljanja na tržište, oni zahtevaju povlačenje sa tržišta ili obezbeđuju povratak od korisnika unutar razumnog vremena, za koji odluče na osnovu vrste opasnosti.	1. When the competent inspectorate, after carrying out an assessment in accordance with Article 31, paragraph 1 of this Regulation, finds that the product, even though it is in accordance with this Regulation, still poses a hazard to the health and safety of persons or domestic animals or property, it shall require the economic operator to take appropriate measures so that the product is no longer hazardous after being placed on the market, requesting its withdrawal from the market or ensuring the return from the user within a reasonable time, which they decide based on the type of hazard.
2. Operatori ekonomik siguron zbatimin e të gjitha veprimeve korrigjuese për të gjitha produktet që ka vënë në dispozicion në tregun e Republikës se Kosovës.	2. Ekonomski operator obezbeđuje sprovođenje svih radnji ispravke za sve proizvode koje je stavio na raspolaganju na tržište Republike Kosovo.	2. The economic operator shall ensure the implementation of all remedial actions for all the products it has made available on the market of the Republic of Kosovo.
Neni 31 **Mospërputhshmëria formale**	**Član 31** **Formalna neusklađenost**	**Article 31** **Formal nonconformity**
1. Pavarësisht nga zbatimi i procedurave nga neni 31 të kësaj Rregullore, inspektori kompetent kërkon nga operatori ekonomik ta	1. Bez obzira od sprovođenje postupaka iz člana 31 ove Uredbe, nadležni inspektor zahteva od ekonomskog operatora da otkloni neusklađenost, ako utvrdi jedno od ovih:	1. Regardless of the implementation of the procedures from Article 31 of this Regulation, the competent inspector shall ask the economic operator to eliminate the

eliminojë mospërputhjen, nëse konstaton një nga këto: 1.1. marka CE nuk është vendosur në përputhje është vendosur në kundërshtim me parimet e përgjithshme sipas nenit 16 të kësaj Rregullore të kësaj Rregullore; 1.2. marka CE, kur kërkohet, nuk është e vendosur; 1.3. etiketa speciale e mbrojtjes kundër shpërthimit Ex, simbolet e grupit dhe kategorisë së pajisjeve dhe, nëse është e nevojshme, etiketat dhe informacionet e tjera nuk vendosen në përputhje me pikën 1.0.5. Shtojcën II të kësaj Rregullore ose nuk janë vendosur; 1.4. numri i identifikimit të trupit të emëruar, kur ky trup përfshihet në fazën e kontrollit të prodhimit, nuk është shënuar në përputhje me nenin 17 të kësaj Rregullore ose nuk është shënuar; 1.5. deklarata e konformitetit ose vërtetimi e konformitetit, sipas rastit, nuk i bashkëngjitet produktit; 1.6. deklarata e konformitetit ose, kur kërkohet, vërtetimi e konformitetit nuk është hartuar saktë, 1.7. dokumentacioni teknik nuk është në dispozicion ose nuk është i plotë;	1.1. znak CE nije stavljen u skladu, stavljena je u suprotnosti sa opštim principima prema članu 16 ove Uredbe; 1.2. znak CE, kada se zahteva, nije stavljen; 1.3. specijalna etiketa zaštite protiv eksplozije Ex, simboli grupe i kategorije opreme iako je potrebno, etikete i druge informacije ne postavljaju se u skladu sa tačkom 1.0.5. Priloga II ove Uredbe ili nisu postavljeni; 1.4. identifikacioni broj imenovanog tela, kada se ovo telo uključuje u fazi kontrole proizvodnje, nije označeno u skladu sa članom 17 ove Uredbe ili nije označeno; 1.5. izjava usaglašenosti ili potvrda usaglašenosti, prema slučaju, ne prilaže se proizvodu; 1.6. izjava usaglašenosti ili, kada se zahteva, potvrda usaglašenosti nije tačno izrađena, 1.7. tehnička dokumentacija nije na raspolaganju ili nije potpuna;	nonconformity, if he or she finds one of the following: 1.1. the CE mark is not placed in accordance with the general principles according to Article 16 of this Regulation; 1.2. the CE mark, when required, is not affixed; 1.3. special explosion protection label Ex, equipment group and category symbols and, as appropriate, labels and other information are not placed in accordance with point 1.0.5. of Annex II to this Regulation or have not been affixed; 1.4. the identification number of the authorized body, when this body is included in the production control phase, is not marked in accordance with Article 17 of this Regulation or is not marked; 1.5. the declaration of conformity or verification of conformity, as appropriate, is not enclosed to the product; 1.6. the declaration of conformity or, where required, the attestation of conformity is not drawn up correctly, 1.7. technical documentation is not available or is incomplete;

1.8. të dhënat nga neni 7, paragrafi 7 ose neni 9, paragrafi 3 të kësaj Rregullore mungojnë, janë të pasakta ose jo të plota; 1.9. çdo kërkesë tjetër administrative nga neni 7 ose neni 9 të kësaj Rregullore nuk është përmbushur.	1.8. podaci iz člana 7, stav 7. ili člana 9, stav 3. ove Uredbe nedostaju, netačni su ili nepotpuni; 1.9. svaki drugi administrativni zahtev iz člana 7 ili člana 9 ove Uredbe nije ispunjen.	1.8. data from Article 7, paragraph 7 or Article 9, paragraph 3 of this Regulation is missing, incorrect or incomplete; 1.9. any other administrative requirement from Article 7 or Article 9 of this Regulation has not been met.
2. Nëse mospërputhja nga paragrafi 1 i këtij neni ende ekziston, inspektorati kompetent merr të gjitha masat e duhura për të kufizuar ose ndaluar vënien e produktit në treg ose për të siguruar kthimin nga përdoruesi ose tërheqjen nga tregu.	2. Ako neusklađenost iz stava 1. ovog člana još uvek postoji, nadležni inspektorat preduzima sve odgovarajuće mere da ograniči ili zabrani stavljanje proizvoda na tržište ili da obezbedi povratak od korisnika ili povlačenje sa tržišta.	2. If the nonconformity from paragraph 1 of this Article still exists, the competent inspectorate shall take all appropriate measures to limit or prohibit the placing of the product on the market or to ensure the return from the user or withdrawal from the market.
Neni 32 **Dispozitat ndëshkuese**	**Član 32** **Kaznene odredbe**	**Article 32** **Punitive provisions**
Operatori ekonomik i cili shkel detyrimet sipas kësaj Rregullore ndëshkohet sipas Ligjit për Kërkesa Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit.	Ekonomski operator koji prekrši obaveze prema ovoj Uredbi kažnjava se prema Zakonu o tehničkim zahtevima za proizvode i ocenjivanju usaglašenosti.	An economic operator violating the obligations under this Regulation shall be punished according to the Law on Technical Requirements for Products and Conformity Assessment.
Neni 33 **Shtojcat e Rregullores**	**Član 33** **Prilozi Uredbe**	**Article 33** **Annexes to the Regulation**
1. Shtojcat I deri në X janë pjesë përbërëse e kësaj Rregullore:	1. Prilozi I do X sastavni su deo ove Uredbe:	1. Annex I to X shall be an integral part of this Regulation:
1.1. Kriteret për përcaktimin e klasifikimit të grupeve të pajisjeve në kategori;	1.1. Kriterijumi za utvrđivanje klasifikacije grupa oprema u kategoriji;	1.1. Criteria determining the classification of equipment groups into categories;

1.2. Kërkesat themelore të shëndetit dhe sigurisë të cilat kanë të bëjnë me projektimin dhe ndërtimin e pajisjeve dhe sistemeve mbrojtëse të destinuara për përdorim në atmosfera potencialisht shpërthyese; 1.3. Moduli B: Ekzaminimi i llojit; 1.4. Moduli D: Konformiteti me llojin bazuar në sigurimin e cilësisë të procesit të prodhimit; 1.5. Moduli F: Konformiteti me llojin bazuar në verifikimin e produktit; 1.6. Moduli C1: Konformiteti me llojin bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit plus testimi i mbikëqyrur i produktit; 1.7. Moduli E: Konformiteti me llojit bazuar në sigurimin e cilësisë së produktit; 1.8. Moduli A: Kontrolli i brendshëm i prodhimit; 1.9. Moduli G: Konformiteti i bazuar në verifikimin e njësisë; 1.10. Deklarata e konformitetit.	1.2. Osnovni zahtevi zdravlja i bezbednosti koji se odnose na projektovanje i izgradnju oprema i zaštitnih sistema namenjenih za korišćenje u potencijalno eksplozivnim atmosferama; 1.3. Modul B: Ispitivanje vrste; 1.4. Modul D: Usaglašenost sa vrstom zasnovana na obezbeđivanju kvaliteta proizvodnog procesa; 1.5. Modul F: Usaglašenost sa vrstom zasnovana na verifikaciju proizvoda; 1.6. Modul C1: Usaglašenost sa vrstom zasnovana na unutrašnju kontrolu proizvodnje plus nadzirano testiranje proizvoda; 1.7. Modul E: Usaglašenost sa vrstom zasnovana na obezbeđivanje kvaliteta proizvoda; 1.8. Modul A: Unutrašnja kontrola proizvodnje; 1.9. Modul G: Usaglašenost zasnovana na verifikaciji jedinice; 1.10. Izjava usaglašenosti.	1.2. Essential health and safety requirements relating to the design and construction of equipment and protective systems intended for use in potentially explosive atmospheres; 1.3. Module B: Type examination; 1.4. Module D: Conformity to type based on quality assurance of the production process; 1.5. Module F: Conformity to type based on product verification; 1.6. Module C1: Conformity to type based on internal production control plus supervised product testing; 1.7. Module E: Conformity to type based on product quality assurance; 1.8. Module A: Internal control of production; 1.9. Module G: Unit verification-based conformity; 1.10. Declaration of conformity.
Neni 34 **Shfuqizimi**	**Član 34** **Ukidanje**	**Article 34** **Repeal**
Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja (MTI) Nr. 04/2014 për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të destinuara për përdorim në atmosfera	Stupanjem na snagu ove Uredbe, Uredba (MTI) br. 04/2014 o opremi i zaštitnim sistemima namenjenim za upotrebu u potencijalno eksplozivnim atmosferama.	Regulation (MTI) No. 04/2014 on equipment and protective systems intended for use in potentially explosive atmospheres shall be

potencialisht shpërthyese. **Neni 35** **Hyrja në fuqi** Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. **Rozeta Hajdari** _____ Ministre i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë Datë: 08.12.2022	**Član 35** **Stupanje na snagu** This regulation shall enter into force on the day of its publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo. **Rozeta Hajdari** _____ Ministarka Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine Datum: 08.12.2022	repealed upon entry into force of this Regulation. **Article 35** **Entry into force** Ova Uredba stupa na snagu danom objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo. **Rozeta Hajdari** _____ Minister of the Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade Date: 08.12.2022

SHTOJCA I

KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E KLASIFIKIMIT TË GRUPEVE TË PAJISJEVE NË KATEGORI

1. Pajisjet e Grupit I

(a) Kategoria e pajisjeve M 1 përfshin pajisje të dizajnuara dhe, kur është e nevojshme, të pajisura me mjete shtesë të veçanta mbrojtjeje për të funksionuar në konformitet me parametrat operacionalë të vendosur nga prodhuesi dhe për të siguruar një nivel shumë të lartë mbrojtjeje.

Pajisjet e kësaj kategorie janë të destinuara për përdorim në pjesët nëntokësore të minierave, si dhe ato pjesë të instalimeve sipërfaqësore të minierave të tilla të rrezikuara nga gazi shpërthyes dhe/ose pluhuri i ndezshëm.

Kërkohet që pajisjet e kësaj kategorie të mbeten funksionale, edhe në rast incidentesh të rralla që lidhen me pajisjet, me një atmosferë shpërthyese të pranishme, dhe karakterizohen nga mjete mbrojtëse të tilla që:

- qoftë, në rast të dështimit të një mjeti mbrojtjeje, të paktën një mjet i dytë i pavarur siguron nivelin e nevojshëm të mbrojtjes,
- ose niveli i nevojshëm i mbrojtjes sigurohet në rast se dy defekte ndodhin në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra.

Pajisjet e kësaj kategorie duhet të jenë në përputhje me kërkesat shtesë të referuara në pikën 2.0.1 të Shtojcës II.

(b) Kategoria e pajisjeve M 2 përfshin pajisje të dizajnuara për të qenë në gjendje të funksionojnë në konformitet me parametrat operacionale të vendosur nga prodhuesi dhe duke siguruar një nivel të lartë mbrojtjeje.

Pajisjet e kësaj kategorie janë të destinuara për përdorim në pjesët nëntokësore të minierave, si dhe ato pjesë të instalimeve sipërfaqësore të minierave të tilla që mund të rrezikohen nga gazi i shpërthyes dhe/ose pluhuri i ndezshëm.

Në rast të një atmosfere shpërthyese, duhet të jetë e mundur të ndërpritet furnizimi me energji elektrike për këtë pajisje.

Mjetet e mbrojtjes në lidhje me pajisjet e kësaj kategorie sigurojnë nivelin e nevojshëm të mbrojtjes gjatë funksionimit normal dhe gjithashtu në rastin e kushteve më të rënda të funksionimit, veçanërisht ato që rrjedhin nga trajtimi i ashpër dhe ndryshimi i kushteve mjedisore.

Pajisjet e kësaj kategorie duhet të jenë në përputhje me kërkesat shtesë të referuara në pikën 2.0.2 të Shtojcës II.

2. Pajisjet-grupi II

(a) Kategoria 1 e pajisjeve përfshin pajisje të dizajnuara për të qenë në gjendje të funksionojnë në konformitet me parametrat operativë të vendosur nga prodhuesi dhe duke siguruar një nivel shumë të lartë mbrojtjeje.

Pajisjet e kësaj kategorie janë të destinuara për përdorim në zona ku atmosferat shpërthyese të shkaktuara nga përzierjet e ajrit dhe gazeve, avujve ose mjegullave ose nga përzierjet e ajrit/pluhurit janë të pranishme vazhdimisht, për periudha të gjata ose qe ndodhin shumë shpesh.

Pajisjet e kësaj kategorie duhet të sigurojnë nivelin e nevojshëm të mbrojtjes, edhe në rast të incidenteve të rralla që lidhen me pajisjet, dhe karakterizohen nga mjetet e mbrojtjes të tilla që:

- qoftë, në rast të dështimit të një mjeti mbrojtjeje, të paktën një mjet i dytë i pavarur siguron nivelin e nevojshëm të mbrojtjes,
- ose niveli i nevojshëm i mbrojtjes sigurohet në rast se dy defekte ndodhin në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra.

Pajisjet e kësaj kategorie duhet të jenë në përputhje me kërkesat shtesë të referuara në pikën 2.1 të Shtojcës II.

(b) Kategoria 2 e pajisjeve përfshin pajisje të dizajnuara për të qenë në gjendje të funksionojnë në përputhje me parametrat operativë të vendosur nga prodhuesi dhe për të siguruar një nivel të lartë mbrojtjeje.

Pajisjet e kësaj kategorie janë të destinuara për përdorim në zona ku atmosfera shpërthyese të shkaktuara nga gazrat, avujt, mjegulla ose përzierjet e ajrit/pluhurit ka të ngjarë të shfaqen herë pas here.

Mjetet e mbrojtjes në lidhje me pajisjet e kësaj kategorie sigurojnë nivelin e duhur të mbrojtjes, të cilat normalisht duhet të merren parasysh edhe në rast të dështimit ose defekteve të pajisjeve që ndodhin shpesh.

Pajisjet e kësaj kategorie duhet të jenë në përputhje me kërkesat shtesë të referuara në pikën 2.2 të Shtojcën II.

(c) Kategoria 3 e pajisjeve përfshin pajisje të dizajnuara për të qenë në gjendje të funksionojnë në përputhje me parametrat e funksionimit të përcaktuara nga prodhuesi dhe për të siguruar një nivel normal mbrojtjeje.

Pajisjet e kësaj kategorie janë të destinuara për përdorim në zona në të cilat atmosfera shpërthyese e shkaktuar nga gazrat, avujt, mjegulla ose përzierjet e ajrit/pluhurit nuk ka gjasa të ndodhin ose, nëse ndodhin, ka të ngjarë të ndodhin rrallë dhe vetëm për një periudhë të shkurtër.

Pajisjet e kësaj kategorie sigurojnë nivelin e nevojshëm të mbrojtjes gjatë funksionimit normal.

Pajisjet e kësaj kategorie duhet të jenë në përputhje me kërkesat shtesë të referuara në pikën 2.3 të Shtojcës II.

SHTOJCA II

KËRKESAT THEMELORE TË SHËNDETIT DHE SIGURISË TË CILAT KANË TË BËJNË ME PROJEKTIMIN DHE NDËRTIMIN E PAJISJEVE DHE SISTEMEVE MBROJTËSE TË DESTINUARA PËR PËRDORIM NË ATMOSFERA POTENCIALISHT SHPËRTHYESE

Vrojtimet paraprake

A. Njohuritë teknologjike, të cilat mund të ndryshojnë me shpejtësi, duhet të merren parasysh sa më shpejt që të jetë e mundur dhe të zbatohen menjëherë.

B. Për mjetet e specifikuara në nenin 2 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të kësaj Rregullore, kërkesat themelore do të zbatohen vetëm në masën sa është e nevojshme për funksionimin e sigurt dhe të besueshëm të këtyre pajisjeve në lidhje me rreziqet e shpërthimit.

Kërkesat e përbashkëta për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse

1.0. Kërkesat e përgjithshme

1.0.1. Parimet e sigurisë së integruar të shpërthimit

Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të destinuara për përdorim në atmosfera potencialisht shpërthyese duhet të dizajnohen nga pikëpamja e sigurisë së integruar të shpërthimit.

Në lidhje me këtë, prodhuesi duhet të marrë masat:

- para së gjithash, nëse është e mundur, për të parandaluar formimin e atmosferave shpërthyese që mund të prodhohen ose lirohen nga pajisjet dhe nga vetë sistemet mbrojtëse,
- për të parandaluar ndezjen e atmosferave shpërthyese, duke marrë parasysh natyrën e çdo burimi elektrik dhe jo elektrik të ndezjes,
- nëse ndodh megjithatë një shpërthim i cili mund të rrezikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi personat dhe, sipas rastit, kafshët shtëpiake ose pronën, të ndalet menjëherë dhe/ose të kufizohet shtrirja e flakëve të shpërthimit dhe presioneve të shpërthimit në një nivel të mjaftueshëm sigurie.

1.0.2. Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të dizajnohen dhe prodhohen pas analizave të duhura të defekteve të mundshme të funksionimit në mënyrë që sa më shumë të jetë e mundur të shmangen situatat e rrezikshme.

Duhet të merret parasysh çdo keqpërdorim i cili mund të parashikohet në mënyrë të arsyeshme.

1.0.3. Kushtet e veçanta të kontrollit dhe mirëmbajtjes

Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse që i nënshtrohen kushteve të veçanta të kontrollit dhe mirëmbajtjes duhet të dizajnohen dhe ndërtohen duke pasur parasysh këto kushte.

1.0.4. Kushtet e zonës rrethuese

Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të dizajnohen dhe ndërtohen në mënyrë që të jenë në gjendje të përballojnë kushtet aktuale ose të parashikueshme të zonës rrethuese.

1.0.5. Shënjimi

Të gjitha pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të shënjohen në mënyrë të lexueshme dhe të pashlyeshme me të dhënat minimale të mëposhtme:

- emri, emri i regjistruar tregtar ose marka e regjistruar tregtare dhe adresa e prodhuesit,
- Shënjimi CE (*shih Shtojcën I të Udhëzimi Administrativ (QRK) nr. 03/2020 për formën dhe përmbajtjen e shenjës së konformitetit dhe mënyrën e njohjes së dokumenteve të huaja të konformitetit*),
- përcaktimi i serisë ose llojit,
- numri i lotit ose serik, nëse ka,
- viti i ndërtimit,
- shënjimi specifik i mbrojtjes nga shpërthimi Ex i shoqëruar nga simboli i grupit dhe kategorisë së pajisjeve,
- për grupin e pajisjeve II, shkronja "G" (në lidhje me atmosferat shpërthyese të shkaktuara nga gazrat, avujt ose mjegulla) dhe/ose
- shkronja "D" (në lidhje me atmosferat shpërthyese të shkaktuara nga pluhuri).
- Për më tepër, aty ku është e nevojshme, ato duhet gjithashtu të shënjohen me të gjitha informacionet thelbësore për përdorimin e tyre të sigurt.

1.0.6. Udhëzimet

(a) Të gjitha pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të shoqërohen me udhëzime, duke përfshirë të paktën të dhënat e mëposhtme:

- një përmbledhje e informacionit me të cilin është shënuar pajisja ose sistemi mbrojtës, përveç lotit ose numrit serik (shih pikën 1.0.5), së bashku me çdo informacion shtesë të përshtatshëm për të lehtësuar mirëmbajtjen (p.sh. adresa e riparuesit, etj.);

- udhëzime për siguri:
- vënia në shërbim,
- përdorimi,
- montimi dhe çmontimi,
- mirëmbajtja (shërbim dhe riparim urgjent),
- instalimi,
- rregullimi/përshtatja;
- kur është e nevojshme, një tregues i zonave të rrezikshme përpara pajisjeve të zbutjes të presionit;
- kur është e nevojshme, udhëzimet e trajnimit;
- detajet që lejojnë marrjen e një vendimi përtej çdo dyshimi nëse një pajisje e një kategorie specifike ose një sistem mbrojtës mund të përdoret në mënyrë të sigurt në zonën e synuar nën kushtet e pritshme të funksionimit;
- parametrat elektrike dhe të presionit, temperaturat maksimale të sipërfaqes dhe vlerat e tjera kufizuese;

- kur është e nevojshme, kushte të veçanta përdorimi, duke përfshirë të dhënat e përdorimin jo të drejtë të mundshëm që përvoja ka treguar se mund të ndodhin;

- kur është e nevojshme, karakteristikat themelore të veglave që mund të vendosen në pajisje ose në sistemin mbrojtës.

(b) Udhëzimet duhet të përmbajnë vizatimet dhe diagramet e nevojshme për vënien në shërbim, mirëmbajtjen, inspektimin, kontrollin e funksionimit të saktë dhe, kur është e përshtatshme, riparimin e pajisjes ose sistemit mbrojtës, së bashku me të gjitha udhëzimet e dobishme, veçanërisht në lidhje me sigurinë.

(c) Literatura që përshkruan pajisjen ose sistemin mbrojtës nuk duhet të jetë në kundërshtim me udhëzimet në lidhje me aspektet e sigurisë.

1.1. *Përzgjedhja e materialeve*

1.1.1. Materialet e përdorura për ndërtimin e pajisjeve dhe sistemeve mbrojtëse nuk duhet të shkaktojnë shpërthim, duke marrë parasysh presionet e parashikueshme të funksionimit.

1.1.2. Brenda kufijve të kushteve të funksionimit të përcaktuara nga prodhuesi, nuk duhet të jetë e mundur që të ndodhë një reagim midis materialeve të përdorura dhe përbërësve të atmosferës potencialisht shpërthyese, të cilat mund të dëmtojnë mbrojtjen nga shpërthimi.

1.1.3. Materialet duhet të zgjidhen në mënyrë që ndryshimet e parashikueshme në karakteristikat e tyre dhe përputhshmëria e tyre në kombinim me materiale të tjera të mos çojnë në një ulje të mbrojtjes së ofruar; në veçanti, duhet të merret parasysh rezistenca ndaj korrozionit dhe konsumit/shpenzimit të materialit, përçueshmëria elektrike, forca mekanike, rezistenca ndaj vjetërsimit dhe efektet e ndryshimeve të temperaturës.

1.2. *Dizajnimi dhe ndërtimi*

1.2.1. Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të dizajnohen dhe ndërtohen duke marrë parasysh njohuritë teknologjike të mbrojtjes nga shpërthimi, në mënyrë që ato të mund të përdoren në mënyrë të sigurt gjatë gjithë jetëgjatësisë së tyre.

1.2.2. Komponentët që do të inkorporohen ose do të përdoren si zëvendësues në pajisje dhe sisteme mbrojtëse duhet të dizajnohen dhe ndërtohen në mënyrë të tillë që të funksionojnë në mënyrë të sigurt për qëllimin e synuar të mbrojtjes nga shpërthimi kur instalohen në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.

1.2.3. Strukturat e mbyllura dhe parandalimi i rrjedhjeve

Pajisjet që mund të lirojnë gazra ose pluhura të ndezshëm, kudo që është e mundur, duhet të përdorin vetëm struktura të mbyllura.

Nëse pajisja përmban hapje ose nyje jo të ngushta, ato duhet të dizajnohen sa më shumë që të jetë e mundur në atë mënyrë që lirimi i gazrave ose pluhurit të mos krijojë atmosfera shpërthyese jashtë pajisjes.

Pikat ku materialet futen ose tërhiqen, sa më shumë që të jetë e mundur, duhet të dizajnohen dhe pajisen në mënyrë që të kufizojnë lëshimet e materialeve të ndezshme gjatë mbushjes ose përdorimit.

1.2.4. Depozitat e pluhurit

Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të cilat synohet të përdoren në zonat e ekspozuara ndaj pluhurit duhet të dizajnohen në mënyrë që pluhuri i depozituar në sipërfaqet e tyre të mos ndizet.

Në përgjithësi, depozitat e pluhurit duhet të kufizohen aty ku është e mundur. Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të jenë lehtësisht të pastrueshme.

Temperaturat sipërfaqësore të pjesëve të pajisjeve duhet të mbahen shumë nën temperaturën e ndezjes të pluhurit të depozituar.

Trashësia e pluhurit të depozituar duhet të merret parasysh dhe nëse është e përshtatshme duhet të merren mjete për të kufizuar temperaturën në mënyrë që të parandalohet akumulimi i nxehtësisë.

1.2.5. Mjetet shtesë të mbrojtjes

Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse që mund të ekspozohen ndaj llojeve të caktuara të presioneve të jashtme duhet të pajisen, kur është e nevojshme, me mjete shtesë mbrojtëse.

Pajisjet duhet t'i rezistojnë sforcimeve përkatëse, pa efekte negative në mbrojtjen nga shpërthimi.

1.2.6. Hapje e sigurt

Nëse pajisjet dhe sistemet mbrojtëse janë në një strehë ose në një kontejnerë të mbyllur që është pjesë e vetë mbrojtjes kundër shpërthimit, duhet të jetë e mundur që të hapet ajo strehë ose kontejner vetëm me një mjet të veçantë ose me anë të masave të përshtatshme mbrojtëse.

1.2.7. Mbrojtja ndaj rreziqeve të tjera

Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të dizajnohen dhe prodhohen në mënyrë që:

(a) të shmangë lëndimet fizike ose dëmtimet e tjera që mund të shkaktohen nga kontakti i drejtpërdrejtë ose i tërthortë;

(b) të sigurojë që nuk prodhohen temperatura sipërfaqësore të pjesëve të qasshme ose rrezatimi i cili do të shkaktonte rrezik;

(c) të eliminojë rreziqet jo-elektrike që zbulohen nga përvoja;

(d) të sigurojë që kushtet e parashikueshme të mbingarkesës të mos krijojnë situata të rrezikshme.

Kur për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse, rreziqet e përmendura në këtë pikë mbulohen tërësisht ose pjesërisht nga legjislacioni tjetër i Kosovës, kjo Rregullore nuk do të zbatohet ose do të pushojë së zbatuari në rastin e pajisjeve dhe sistemeve të tilla mbrojtëse dhe të rreziqeve të tilla me rastin e aplikimit të atij legjislacioni specifik të Kosovës.

1.2.8. Mbingarkesa e pajisjeve

Mbingarkimi i rrezikshëm i pajisjeve duhet të parandalohet në fazën e dizajnimit me anë të pajisjeve të integruara të matjes, rregullimit dhe kontrollit, të tilla si kufizues tensionit të rrymës, kufizuesit e temperaturës, ndërprerësit e presionit të diferencuar, matësit e rrjedhës, reletë me vonesë kohore, monitorët e shpejtësisë së tepërt dhe/ose lloje të ngjashme të pajisjeve monitoruese.

1.2.9. Sistemet e mbyllura kundër zjarrit

Nëse pjesët që mund të ndezin një atmosferë shpërthyese vendosen në një sistem të mbyllur, duhet të merren masa për të siguruar ajo të përballojë presionin e zhvilluar gjatë një shpërthimi të brendshëm të një përzierjeje shpërthyese dhe të parandalojë transmetimin e shpërthimit në atmosferën shpërthyese që rrethon sistemin e mbyllur.

1.3. *Burimet e mundshme të ndezjes*

1.3.1. Rreziqet që vijnë nga burime të ndryshm e ndezjeje

Burime të mundshme të ndezjes si shkëndijat, flakët, harqet elektrikë, temperaturat e larta të sipërfaqes, energjia akustike, rrezatimi optik, valët elektromagnetike dhe burime të tjera ndezëse nuk duhet të ndodhin.

1.3.2. Rreziqet që vijnë nga elektriciteti statik

Ngarkesat elektrostatike që mund të rezultojnë në shkarkime të rrezikshme duhet të parandalohen me anë të masave të duhura.

1.3.3. Rreziqet që rrjedhin nga energjia elektrike e humbur dhe që rrjedh jashtë

Duhet të parandalohet energjia elektrike e humbur dhe ajo që rrjedh jashtë sistemit në pjesët e pajisjeve përcjellëse, të cilat mund të rezultojnë, për shembull, në shfaqjen e korrozionit të rrezikshëm, mbinxehje të sipërfaqeve ose shkëndija që mund të provokojnë një ndezje.

1.3.4. Rreziqet që vijnë nga mbinxehja

Mbinxehja e shkaktuar nga fërkimi ose ndikimet që ndodhin, për shembull, ndërmjet materialeve dhe pjesëve në kontakt me njëra-tjetrën gjatë rrotullimit ose përmes ndërhyrjes së trupave të huaj, duhet për aq sa është e mundur të parandalohet në fazën e projektimit.

1.3.5. Rreziqet që lindin nga operacionet e kompensimit të presionit

Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të dizajnohen ose pajisen në mënyrë të tillë me mjete të integruara matëse, kontrolluese dhe rregulluese që kompensimet e presionit të cilat rrjedhin prej tyre të mos gjenerojnë valë goditëse ose ngjeshje e cila mund të shkaktoj ndezje.

1.4. *Rreziqet që vijnë nga efektet e jashtme*

1.4.1. Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të dizajnohen dhe ndërtohen në mënyrë që të jenë në gjendje të kryejnë funksionin e tyre të synuar në siguri të plotë, edhe në kushtet e ndryshimit mjedisor dhe në prani të tensioneve të jashtme, lagështisë, dridhjeve, ndotjes dhe efekteve të tjera të jashtme, duke marrë parasysh kufizimet e kushteve të funksionimit të përcaktuara nga prodhuesi.

1.4.2. Pjesët e pajisjeve të përdorura duhet të jenë të përshtatshme për presionet e synuara mekanike dhe termike dhe të afta për t'i bërë ballë sulmeve nga substancat ekzistuese ose agresive të parashikueshme.

1.5. *Kërkesat në lidhje me pajisjet e lidhura me sigurinë*

1.5.1. Pajisjet e sigurisë duhet të funksionojnë në mënyrë të pavarur nga çdo pajisje matëse dhe/ose kontrolli të nevojshëm për funksionimin.

Për aq sa është e mundur, dështimi i një pajisjeje sigurie duhet të zbulohet mjaft shpejt me mjete teknike të përshtatshme për të siguruar që ka shumë pak gjasa që të ndodhin situata të rrezikshme.

Parimi i sigurisë në rast dështimi duhet të zbatohet në përgjithësi.

Ndërpresësi i lidhur me sigurinë në përgjithësi duhet të aktivizojë drejtpërdrejt pajisjet përkatëse të kontrollit pa komandën e ndërmjetme të softuerit.

1.5.2. Në rast të dështimit të pajisjes së sigurisë, pajisjet dhe/ose sistemet mbrojtëse kudo që është e mundur duhet të sigurohen.

1.5.3. Kontrollet e ndalimit emergjent të pajisjeve të sigurisë duhet, sa më shumë që të jetë e mundur, të pajisen me bllokada të rinisjes/rindezjes. Një komandë e re nisjeje/ndezjeje mund të filloj funksionimin normal vetëm pasi bllokadat e rinisjes të jenë rivendosur qëllimisht.

1.5.4. Njësitë e kontrollit dhe monitorit

Kur përdoren njësitë e kontrollit dhe të monitorit, ato duhet të dizajnohen në përputhje me parimet ergonomike në mënyrë që të arrihet niveli më i lartë i mundshëm i sigurisë së funksionimit në lidhje me rrezikun e shpërthimit.

1.5.5. Kërkesat në lidhje me pajisjet me funksion matës për mbrojtjen nga shpërthimi

Për aq sa ato lidhen me pajisjet e përdorura në atmosfera shpërthyese, pajisjet me funksion matës duhet të dizajnohen dhe ndërtohen në mënyrë që ato të mund të përballojnë kërkesat e parashikuara të funksionimit dhe kushtet e veçanta të përdorimit.

1.5.6. Kurdo që është e nevojshme, duhet të jetë e mundur që të kontrollohet saktësia e leximit dhe shërbimi i pajisjeve me funksion matës.

1.5.7. Dizajni i pajisjeve me funksion matës duhet të përfshijë një faktor sigurie i cili siguron që pragu i alarmit të jetë mjaftueshëm jashtë kufijve të shpërthimit dhe/ose ndezjes së atmosferës e cila do të regjistrohet, duke marrë parasysh, në veçanti, kushtet e funksionimit të instalimit dhe devijimet e mundshme në sistemin matës.

1.5.8. Rreziqet që lindin nga softueri

Në projektimin e pajisjeve të kontrolluara me softuer, sistemeve mbrojtëse dhe pajisjeve të sigurisë, në veçanti duhet të merren parasysh rreziqet që rrjedhin nga defektet në program.

1.6. Integrimi i kërkesave të sigurisë në lidhje me sistemin

1.6.1. Duhet të jetë i mundur kontrolli manual në mënyrë që të mbyllen pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të përfshira në procese automatike të cilat devijojnë nga kushtet e synuara të funksionimit, me kusht që kjo të mos rrezikojë sigurinë.

1.6.2. Kur aktivizohet sistemi i fikjes emergjente, energjia e akumuluar duhet të shpërndahet sa më shpejt dhe në mënyrë të sigurtë ose të izolohet në mënyrë që të mos përbëjë më rrezik.

Kjo nuk vlen për energjinë e ruajtur elektrokimike.

1.6.3. Rreziqet që vijnë nga ndërprerja e rrymës

Kur pajisjet dhe sistemet mbrojtëse mund të shkaktojnë një përhapje të rreziqeve shtesë në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike, duhet të jetë e mundur që funksionimi të ruhet në një gjendje të sigurt pavarësisht nga pjesa tjetër e instalimit.

1.6.4. Rreziqet që lindin nga lidhjet

Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të pajisen me hyrje të përshtatshme kabllore dhe kanalesh përçimi.

Kur synohet që pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të përdoren në kombinim me pajisje dhe sisteme të tjera mbrojtëse, atëherë ndërfaqja duhet të jetë e sigurt.

1.6.5. Vendosja e pajisjeve paralajmëruese si pjesë e pajisjeve

Kur pajisjet ose sistemet mbrojtëse janë të pajisura me pajisje zbulimi ose alarmi për monitorimin e shfaqjes së atmosferave shpërthyese, duhet të jepen udhëzimet e nevojshme për të mundësuar vendosjen e tyre në vendet e duhura.

2. Kërkesa plotësuese në lidhje me pajisjet

2.0. Kërkesat e zbatueshme për pajisjet në grupin e pajisjeve I

2.0.1. Kërkesat e aplikueshme për pajisjet e kategorisë M1 të pajisjeve të grupit I

2.0.1.1. Pajisjet duhet të dizajnohen dhe ndërtohen në mënyrë që burimet e ndezjes të mos aktivizohen, edhe në rast të incidenteve të rralla që lidhen me pajisjet.

Pajisjet duhet të pajisen me mjete mbrojtëse të tilla që:

- qoftë, në rast të dështimit të një mjeti mbrojtjeje, të paktën një mjet i dytë i pavarur siguron nivelin e nevojshëm të mbrojtjes,

- ose, niveli i nevojshëm i mbrojtjes sigurohet në rast se dy defekte ndodhin në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra.

Kur është e nevojshme, pajisjet duhet të pajisen me mjete shtesë të veçanta mbrojtëse.

Pajisja duhet të mbetet funksionale me një atmosferë shpërthyese të pranishme.

2.0.1.2. Aty ku është e nevojshme, pajisjet duhet të ndërtohen në mënyrë të tillë që pluhuri të mos mund të depërtojë në to.

2.0.1.3. Temperaturat sipërfaqësore të pjesëve të pajisjeve duhet të mbahen nën temperaturën e ndezjes së përzierjeve të parashikueshme të ajrit/pluhurit, në mënyrë që të parandalohet ndezja e grimcave të pluhurit.

2.0.1.4. Pajisjet duhet të dizajnohen në atë mënyrë që hapja e pjesëve të pajisjeve të cilat mund të jenë burim ndezjeje të jetë e mundur vetëm në kushte joaktive ose të sigurta. Kur nuk është e mundur që të ofrohen pajisje jo aktive, atëherë prodhuesi duhet të vendosë një etiketë paralajmëruese në pjesën e hapjes së pajisjes.

Nëse është e nevojshme, pajisjet duhet të pajisen me sisteme të përshtatshme shtesë të ndërlidhjes.

2.0.2. Kërkesat e aplikueshme për pajisjet e kategorisë M2 të pajisjeve të grupit I

2.0.2.1. Pajisjet duhet të pajisen me mjete mbrojtëse që sigurojnë që burimet e ndezjes të mos aktivizohen gjatë funksionimit normal, edhe në kushte më të vështira të funksionimit, veçanërisht ato që vijnë nga trajtimi i vrazhdë dhe ndryshimi i kushteve mjedisore.

Synohet që pajisja të mbetet pa energji në rast të një atmosfere shpërthyese.

2.0.2.2. Pajisjet duhet të dizajnohen në atë mënyrë që hapja e pjesëve të pajisjeve që mund të jenë burime ndezjeje të jetë e mundur vetëm në kushte joaktive ose nëpërmjet sistemeve të përshtatshme të ndërlidhjes. Kur nuk është e mundur të ofrohen pajisje jo aktive, prodhuesi duhet të vendosë një etiketë paralajmëruese në pjesën e hapjes së pajisjes.

2.0.2.3. Duhet të zbatohen kërkesat në lidhje me rreziqet e shpërthimit që lindin nga pluhuri, të zbatueshme për pajisjet e kategorisë M 1.

2.1. *Kërkesat e zbatueshme për pajisjet e kategorisë 1 të pajisjeve të grupit II*

2.1.1. Atmosferat shpërthyese të shkaktuara nga gazrat, avujt ose mjegulla

2.1.1.1. Pajisjet duhet të dizajnohen dhe ndërtohen në mënyrë që burimet e ndezjes të mos aktivizohen, edhe në rast të incidenteve të rralla që lidhen me pajisjet.

Ato duhet të jenë të pajisura me mjete mbrojtëse të tilla që:

- qoftë, në rast të dështimit të një mjeti mbrojtjeje, të paktën një mjet i dytë i pavarur siguron nivelin e nevojshëm të mbrojtjes,

- ose, niveli i nevojshëm i mbrojtjes sigurohet në rast se dy defekte ndodhin në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra.

2.1.1.2. Për pajisjet me sipërfaqe që mund të nxehen, duhet të merren masa për të siguruar që temperaturat maksimale të deklaruara të sipërfaqes të mos tejkalohen edhe në rrethanat më të pafavorshme.

Duhet gjithashtu të merren parasysh rritja e temperaturës e shkaktuar nga akumulimi i nxehtësisë dhe reaksionet kimike.

2.1.1.3. Pajisjet duhet të dizajnohen në mënyrë të tillë që hapja e pjesëve të pajisjeve që mund të jenë burime ndezjeje të jetë e mundur vetëm në kushte joaktive ose të sigurta. Kur nuk është e mundur të ofrohen pajisje jo aktive, prodhuesi duhet të vendosë një etiketë paralajmëruese në pjesën e hapjes së pajisjes.

Nëse është e nevojshme, pajisjet duhet të pajisen me sisteme të përshtatshme shtesë të ndërlidhjes.

2.1.2. Atmosferat shpërthyese të shkaktuara nga përzierjet e ajrit/pluhurit

2.1.2.1. Pajisjet duhet të dizajnohen dhe ndërtohen në mënyrë që ndezja e përzierjeve të ajrit/pluhurit të mos ndodhë edhe në rast incidentesh të rralla që lidhen me pajisjet.

Ato duhet të jenë të pajisura me mjete mbrojtëse të tilla që:

- qoftë, në rast të dështimit të një mjeti mbrojtjeje, të paktën një mjet i dytë i pavarur siguron nivelin e nevojshëm të mbrojtjes,

- ose, niveli i nevojshëm i mbrojtjes sigurohet në rast se dy defekte ndodhin në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra.

2.1.2.2. Kur është e nevojshme, pajisjet duhet të dizajnohen në atë mënyrë që pluhuri të mund të hyjë ose të dalë nga pajisja vetëm në pika posaçërisht të përcaktuara.

Kjo kërkesë duhet të plotësohet gjithashtu edhe nga hyrjet e kabllove dhe pjesët lidhëse.

2.1.2.3. Temperaturat sipërfaqësore të pjesëve të pajisjeve duhet të mbahen shumë nën temperaturën e ndezjes së përzierjeve të parashikueshme të ajrit/pluhurit në mënyrë që të parandalohet ndezja e grimcave të pluhurit.

2.1.2.4. Në lidhje me hapjen e sigurt të pjesëve të pajisjeve, zbatohet kërkesa 2.1.1.3.

2.2. *Kërkesat e zbatueshme për pajisjet e kategorisë 2 të pajisjeve të grupit II*

2.2.1. Atmosferat shpërthyese të shkaktuara nga gazrat, avujt ose mjegulla

2.2.1.1. Pajisjet duhet të dizajnohen dhe ndërtohen në mënyrë që të parandalojnë lindjen e burimeve të ndezjes, edhe në rast të pengesave ose defekteve të funksionimit të pajisjeve që ndodhin shpesh, dhe të cilat normalisht duhet të merren parasysh.

2.2.1.2. Pjesët e pajisjeve duhet të dizajnohen dhe ndërtohen në mënyrë që temperaturat e deklaruara të sipërfaqes së tyre të mos tejkalohen, edhe në rastin e rreziqeve që vijnë nga situata jonormale të parashikuara nga prodhuesi.

2.2.1.3. Pajisjet duhet të dizajnohen në atë mënyrë që hapja e pjesëve të pajisjeve që mund të jenë burime ndezjeje të jetë e mundur vetëm në kushte joaktive ose nëpërmjet sistemeve të përshtatshme të ndërlidhjes. Kur nuk është e mundur të ofrohen pajisje jo aktive, prodhuesi duhet të vendosë një etiketë paralajmëruese në pjesën e hapjes së pajisjes.

2.2.2. Atmosferat shpërthyese të shkaktuara nga gazrat e ajrit/pluhurit

2.2.2.1. Pajisjet duhet të dizajnohen dhe ndërtohen në mënyrë që ndezja e përzierjeve të ajrit/pluhurit të parandalohet, edhe në rast të pengesave që ndodhin shpesh ose defekteve të funksionimit të pajisjeve, të cilat normalisht duhet të merren parasysh.

2.2.2.2. Në lidhje me temperaturat e sipërfaqes, zbatohet kërkesa 2.1.2.3.

2.2.2.3. Në lidhje me mbrojtjen nga pluhuri, zbatohet kërkesa 2.1.2.2.

2.2.2.4. Në lidhje me hapjen e sigurt të pjesëve të pajisjeve, zbatohet kërkesa 2.2.1.3.

2.3. Kërkesat e zbatueshme për pajisjet e kategorisë 3 të grupit të pajisjeve II

2.3.1. Atmosferat shpërthyese të shkaktuara nga gazrat, avujt ose mjegulla

2.3.1.1. Pajisjet duhet të dizajnohen dhe ndërtohen në mënyrë që të parandalojnë burimet e parashikueshme të ndezjes që mund të ndodhin gjatë funksionimit normal.

2.3.1.2. Temperaturat e sipërfaqes nuk duhet të kalojnë temperaturat maksimale të deklaruara të sipërfaqes në kushtet e synuara të funksionimit. Në rrethana të jashtëzakonshme mund të lejohen temperatura më të larta vetëm nëse prodhuesi miraton masa të veçanta mbrojtëse shtesë.

2.3.2. Atmosferat shpërthyese të shkaktuara nga përzierjet e ajrit/pluhurit

2.3.2.1. Pajisjet duhet të dizajnohen dhe ndërtohen në mënyrë të tillë që përzierjet e ajrit/pluhurit të mos mund të ndizen nga burime të parashikueshme të ndezjes që ka të ngjarë të ekzistojnë gjatë funksionimit normal.

2.3.2.2. Në lidhje me temperaturat e sipërfaqes, zbatohet kërkesa 2.1.2.3.

2.3.2.3. Pajisjet, duke përfshirë hyrjet e kabllove dhe pjesët lidhëse, duhet të jenë të ndërtuara në mënyrë që, duke marrë parasysh madhësinë e grimcave të tyre, pluhuri nuk mund të krijojë përzierje shpërthyese me ajrin dhe as të formojë akumulime të rrezikshme brenda pajisjes.

3. Kërkesa plotësuese në lidhje me sistemet mbrojtëse

3.0. Kërkesat e përgjithshme

3.0.1. Sistemet mbrojtëse duhet të dimensionohen në atë mënyrë që të reduktojnë efektet e një shpërthimi në një nivel të mjaftueshëm sigurie.

3.0.2. Sistemet mbrojtëse duhet të jenë të dizajnuara dhe në gjendje për t'u vendosur në mënyrë të tillë që të parandalohet përhapja e shpërthimeve përmes reaksioneve dhe shkëndijave të rrezikshme zinxhirore dhe që shpërthimet fillestare të mos shndërrohen në detonime.

3.0.3. Në rast të ndërprerjes së energjisë, sistemet mbrojtëse duhet të ruajnë kapacitetin e tyre për të funksionuar për një periudhë të mjaftueshme në mënyrë që të shmangen situatat e rrezikshme.

3.0.4. Sistemet mbrojtëse nuk duhet të dështojnë për shkak të ndërhyrjeve të jashtme.

3.1. Planifikimi dhe projektimi

3.1.1. Karakteristikat e materialeve

Në lidhje me karakteristikat e materialeve, presioni dhe temperatura maksimale që duhet të merren parasysh në fazën e planifikimit është presioni i pritshëm gjatë një shpërthimi që ndodh në kushte ekstreme operimi dhe efekti i pritshëm i ngrohjes i flakës.

3.1.2. Sistemet mbrojtëse të krijuara për t'i rezistuar ose për të frenuar shpërthimet duhet të jenë në gjendje të përballojnë valën e goditjes të prodhuar pa humbur integritetin e sistemit.

3.1.3. Aksesorët e lidhur me sistemet mbrojtëse duhet të jenë në gjendje të përballojnë presionin maksimal të pritshëm të shpërthimit pa humbur kapacitetin e tyre për të funksionuar.

3.1.4. Në planifikimin dhe projektimin e sistemeve mbrojtëse duhet të merren parasysh reaksionet e shkaktuara nga presioni në pajisjet periferike dhe tubacionet e lidhura.

3.1.5. Sistemet e lehtësimit të presionit

Nëse ka të ngjarë që sforcimet në sistemet mbrojtëse të tejkalojnë forcën e tyre strukturore, atëherë në projektim duhet të parashihen pajisje të përshtatshme për lehtësimin e presionit që nuk rrezikojnë personat në afërsi.

3.1.6. Sistemet e frenimit të shpërthimit

Sistemet e frenimit të shpërthimit duhet të planifikohen dhe dizajnohen në mënyrë të tillë që të reagojnë ndaj një shpërthimi fillestar që në fazën më të hershme të mundshme në rast të një incidenti dhe ta neutralizojnë atë në mënyrë të efektshme, duke pasur parasysh shkallën maksimale të rritjes së presionit dhe të presionin maksimal të shpërthimit.

3.1.7. Sistemet e ndarjes së shpërthimit

Sistemet e ndarjes që synojnë shkëputjen sa më të shpejtë të pajisjeve specifike në rast të shpërthimeve fillestare me anë të pajisjeve të përshtatshme duhet të planifikohen dhe dizajnohen në mënyrë që të mbeten prova kundër transmetimit të ndezjes së brendshme dhe të ruajnë forcën e tyre mekanike në kushtet e funksionimit.

3.1.8. Sistemet mbrojtëse duhet të jenë në gjendje të integrohen në një qark me një prag të përshtatshëm alarmi, në mënyrë që, nëse është e nevojshme, të ketë ndërprerje të furnizimit dhe daljes së produktit dhe mbylljen e pjesëve të pajisjeve të cilat nuk mund të funksionojnë më në mënyrë të sigurt.

SHTOJCA III

MODULI B: EXAMINIMI I LLOJIT

1. Ekzaminimi i llojit është pjesa e një procedure vlerësimi të konformitetit në të cilën trupi i emëruar shqyrton dizajnin teknik të një produkti dhe verifikon dhe vërteton se dizajni teknik i produktit plotëson kërkesat e kësaj Rregullore të cilat zbatohen për të.

2. Ekzaminimi i llojit kryhet përmes ekzaminimit të mostre të produktit, përfaqësues i prodhimit të ardhshëm (lloji i prodhimit).

3. Prodhuesi duhet të paraqet një kerkesë për ekzaminim të llojit vetëm tek një trupi i emëruar i sipas zgjedhjes së tij.

Kërkesa duhet të përfshijë:

(a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, nëse kërkesa është paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar, emrin dhe adresën e tij gjithashtu,

(b) një deklaratë me shkrim se e njëjta kërkesë nuk është depozituar në asnjë trup i emëruar tjetër,

(c) dokumentacionin teknik. Dokumentacioni teknik do të bëjë të mundur vlerësimin e konformitetit të produktit me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore dhe do të përfshijë një analizë dhe vlerësim adekuat të rrezikut(qeve). Dokumentacioni teknik do të specifikojë kërkesat e zbatueshme dhe do të mbulojë, për aq sa është e rëndësishme për vlerësimin, dizajnimin, prodhimin dhe funksionimin e produktit. Dokumentacioni teknik duhet të përmbajë të paktën elementet e mëposhtme:

(i) një përshkrim të përgjithshëm të produktit,

(ii) vizatimet dhe skemat konceptuale të dizajnimit dhe prodhimit të komponentëve, nën-montazheve, qarqeve, etj,

(iii) përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për të kuptuar ato vizatime dhe skema dhe funksionimin e produktit,

(iv) një listë të standardeve të harmonizuara të zbatuara plotësisht ose pjesërisht, referencat e të cilave janë botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe kur ato standarde të harmonizuara nuk janë zbatuar, përshkrimet e zgjidhjeve të miratuara për të përmbushur kërkesat themelore të shëndetit dhe sigurisë të kësaj Rregullore, duke përfshirë një listë të specifikimeve të tjera teknike përkatëse të aplikuara. Në rast të standardeve të harmonizuara pjesërisht të zbatuara, dokumentacioni teknik do të specifikojë pjesët që janë zbatuar,

(v) rezultatet e llogaritjeve të projektimeve të bëra, ekzaminimet e kryera, etj, dhe

(vi) raportet e testimit,

(d) mostrat përfaqësuese të prodhimit të parashikuar. Trupi i emëruar mund të kërkojë mostra të mëtejshme nëse nevojiten për kryerjen e programit të testimit.

4. Trupi i emëruar duhet:

4.1. të ekzaminoj dokumentacionin teknik, të verifikoj që mostrat janë prodhuar në përputhje me dokumentacionin teknik dhe të identifikoj elementët që janë projektuar në përputhje me dispozitat e zbatueshme të standardeve përkatëse të harmonizuara, si dhe elementët që janë projektuar në përputhje me specifikimet e tjera përkatëse teknike;

4.2. të kryejë ekzaminimet dhe testet e duhura, ose të bëjë që ato të kryhen, të kontrolloj nëse ato janë zbatuar në mënyrë korrekte atëherë kur prodhuesi ka zgjedhur të zbatojë zgjidhjet në standardet përkatëse të harmonizuara;

4.3. të kryejë ekzaminimet dhe testet e duhura, ose të bëjë që ato të kryhen, të kontrolloj nëse zgjidhjet e miratuara nga prodhuesi duke aplikuar specifikime të tjera teknike përkatëse plotësojnë kërkesat themelore përkatëse të shëndetit dhe sigurisë sipas kësaj Rregullore, atëherë kur zgjidhjet në standardet përkatëse të harmonizuara nuk janë zbatuar;

4.4. të dakordohet me prodhuesin për një vend ku do të kryhen ekzaminimet dhe testet.

5. Trupi i emëruar harton një raport vlerësimi i cili regjistron aktivitetet e ndërmarra në përputhje me pikën 4 dhe rezultatet e tyre. Pa cenuar detyrimet e tij kundrejt autoriteteve emëruese, trupi i emëruar do të publikojë përmbajtjen e atij raporti, plotësisht ose pjesërisht, vetëm me marrëveshjen e prodhuesit.

6. Kur lloji plotëson kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen për produktin në fjalë, trupi i emëruar i lëshon prodhuesit certifikatën ekzaminimi të llojit. Ajo certifikatë përmban emrin dhe adresën e prodhuesit, përfundimet e ekzaminimit, kushtet (nëse ka) për vlefshmërinë e saj dhe të dhënat e nevojshme për identifikimin e llojit të miratuar. Certifikata e ekzaminimi të llojit mund të ketë një ose më shumë anekse të bashkangjitura.

Certifikata e ekzaminimit të llojit BE dhe anekset e saj do të përmbajnë të gjithë informacionin përkatës për të lejuar vlerësimin e konformitetit të produkteve të prodhuara me llojin e ekzaminuar dhe për të lejuar kontrollin gjatë shërbimit.

Kur lloji nuk plotëson kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore, trupi i emëruar refuzon të lëshojë një certifikatën e ekzaminimit të llojit dhe informon aplikuesin në përputhje me rrethanat, duke dhënë arsye të hollësishme për refuzimin e tij.

7. Trupi i emëruar do të jetë i informuar për çdo ndryshim në gjendjen e njohur përgjithësisht të teknologjisë që tregon se lloji i miratuar mund të mos përputhet më me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore dhe do të përcaktojë nëse këto ndryshime kërkojnë hetim të mëtejshëm. Nëse po, trupi i emëruar duhet të informojë prodhuesin në përputhje me rrethanat.

Prodhuesi informon trupin e emëruar që mban dokumentacionin teknik në lidhje me certifikatën e ekzaminimit të llojit për të gjitha modifikimet e llojit të miratuar që mund të ndikojnë në përputhshmërinë e produktit me kërkesat themelore të shëndetit dhe sigurisë të kësaj direktive ose kushtet për vlefshmërinë e asaj certifikate. Modifikime të tilla do të kërkojnë miratim shtesë në formën e një shtojce në certifikatën origjinale të ekzaminimi të llojit.

8. Çdo trup i emëruar informon autoritetin emërues në lidhje me certifikatat e ekzaminimit të llojit dhe/ose çdo shtojcë në të cilën ai ka lëshuar ose tërhequr dhe në mënyrë periodike ose sipas kërkesës, do t'i vë në dispozicion autoritetit emërues listën e certifikatave të tilla dhe/ose çdo shtesë të refuzuar, pezulluar ose të kufizuar.

Çdo trup i emëruar do të informojë trupat e tjera të emëruara në lidhje me certifikatat e ekzaminimit të llojit dhe/ose çdo shtesë në to të cilën e ka refuzuar, tërhequr, pezulluar ose kufizuar në ndonjë mënyrë tjetër, dhe, sipas kërkesës, në lidhje me këto certifikata dhe/ose shtojca të cilat i ka lëshuar.

Autoriteti emërues, inspektorati kompetent dhe trupat tjera të emëruara, sipas kërkesës, mund të sigurojnë një kopje të certifikatave të ekzaminimit të llojit dhe/ose shtojcave në to. Me kërkesë, Autoriteti emërues dhe inspektorati kompetent mund të marrin një kopje të dokumentacionit teknik dhe të rezultateve të ekzaminimeve të kryera nga trupi i emëruar. Trupi i emëruar do të ruaj një kopje të certifikatës së ekzaminimit të llojit, anekset dhe shtesat e saj, si dhe dosjen teknike duke përfshirë dokumentacionin e paraqitur nga prodhuesi, deri në skadimin e vlefshmërisë së asaj certifikate.

9. Prodhuesi do të mbajë në dispozicion të inspektoratit kompetente një kopje të certifikatës së ekzaminimit të llojit, anekset dhe shtesat e saj së bashku me dokumentacionin teknik për dhjetë (10) vite pasi produkti të jetë vendosur në treg.

10. Përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit mund të bëjë kërkesën e përcaktuar në pikën 3 dhe të përmbushë detyrimet e përcaktuara në pikat 7 dhe 9, me kusht që ato të jenë të përcaktuara në autorizim.

SHTOJCA IV

MODULI D: KONFORMITETI ME LLOJIN BAZUAR NË SIGURIMIN E CILËSISË TË PROCESIT TË PRODHIMIT

1. Konformiteti me llojin bazuar në sigurimin e cilësisë së procesit të prodhimit është pjesë e një procedure të vlerësimit të konformitetit ku prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 5 dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësinë e tij të vetme që produktet në fjalë janë në përputhje me llojin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të llojit dhe plotësojnë kërkesat e kësaj Rregullore të cilat zbatohen për to.

2. Prodhimi

Prodhuesi duhet të operojë një sistem të miratuar të cilësisë për prodhimin, inspektimin e produktit përfundimtar dhe testimin e produkteve në fjalë, siç specifikohet në pikën 3 si dhe do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes siç specifikohet në pikën 4.

3. Sistemi i cilësisë

3.1. Prodhuesi duhet të paraqesë një kërkesë tek trupi i emëruar sipas zgjedhjes së tij, për produktet në fjalë për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë.

Kërkesa duhet të përfshijë:

(a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe nëse kërkesa është paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar, emrin dhe adresën e tij gjithashtu,

(b) deklaratën me shkrim se e njëjta kërkesë nuk është paraqitur në asnjë trup tjetër të emëruar,

(c) të gjithë informacionin përkatës për kategorinë e produktit të parashikuar,

(d) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë,

(e) dokumentacionin teknik të llojit të miratuar dhe një kopje të certifikatës së ekzaminimit të llojit.

3.2. Sistemi i cilësisë duhet të sigurojë që produktet të jenë në përputhje me llojin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të llojit dhe të jenë në përputhje me kërkesat e kësaj Rregullore të cilat zbatohen për to.

Të gjithë elementët, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga prodhuesi do të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave, procedurave dhe udhëzimeve të shkruara. Dokumentacioni i sistemit të cilësisë do të lejojë një interpretim të qëndrueshëm të programeve, planeve, manualeve dhe të dhënave të cilësisë.

Në veçanti, dokumentacioni duhet të përmbajë një përshkrim adekuat të:

(a) Objektivave të cilësisë dhe strukturën organizative, përgjegjësitë dhe kompetencat e menaxhmentit në lidhje me cilësinë e produktit,

(b) teknikave përkatëse të prodhimit, kontrollit të cilësisë dhe sigurimit të cilësisë, proceset dhe veprimet sistematike që do të përdoren,

(c) ekzaminimeve dhe testeve që do të kryhen para, gjatë dhe pas prodhimit, dhe shpeshtësinë me të cilën do të kryhen,

(d) të dhënave të cilësisë, të tilla si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testimit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit për personelin në fjalë, etj, dhe

(e) mjeteve për monitorimin e arritjes së cilësisë së kërkuar të produktit dhe funksionimin efektiv të sistemit të cilësisë.

3.3. Trupi i emëruar vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai plotëson kërkesat e përcaktuara në pikën 3.2.

Ai do të prezumojë konformitetin me këto kërkesa në lidhje me elementët e sistemit të cilësisë që përputhen me specifikimet përkatëse të standardit të harmonizuar përkatës.

Përveç përvojës në sistemet e menaxhimit të cilësisë, ekipi i auditimit duhet të ketë të paktën një anëtar me përvojë vlerësimi në fushën përkatëse të produktit dhe teknologjinë e produktit në fjalë, dhe njohuri për kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore. Auditimi do të përfshijë një vizitë vlerësimi në ambientet e prodhuesit. Ekipi i auditimit do të shqyrtojë dokumentacionin teknik të përcaktuar në pikën 3.1(e) për të verifikuar aftësinë e prodhuesit për të identifikuar kërkesat përkatëse të kësaj Rregullore dhe për të kryer ekzaminimet e nevojshme me synimin për të siguruar përputhjen e produktit me këto kërkesa.

Vendimi i prezantohet prodhuesit. Njoftimi përmban konkluzionet e auditimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.4. Prodhuesi do të marrë përsipër të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga sistemi i cilësisë siç është miratuar dhe ta mirëmbajë atë në mënyrë që ky sistem të mbetet i përshtatshëm dhe efikas.

3.5. Prodhuesi duhet ta mbajë të informuar trupin e emëruar që ka miratuar sistemin e cilësisë për çdo ndryshim që synon të kryej në sistemin e cilësisë.

Trupi i emëruar vlerëson çdo ndryshim të propozuar dhe vendos nëse sistemi i modifikuar i cilësisë do të vazhdojë të përmbushë kërkesat e përmendura në pikën 3.2 ose nëse është i nevojshëm një rivlerësim.

Trupi i emëruar do të njoftojë prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi përmban konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e trupit të emëruar

4.1. Qëllimi i mbikëqyrjes është të sigurohet që prodhuesi përmbush siç duhet detyrimet që dalin nga sistemi i miratuar i cilësisë.

4.2. Për qëllime vlerësimi, prodhuesi do t'i lejojë trupit të emëruar hyrjen në vendet e prodhimit, inspektimit, testimit dhe magazinimit dhe duhet t'i sigurojë atij të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti:

(a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë,

(b) të dhënat e cilësisë, të tilla si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testimit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit për personelin në fjalë, etj.

4.3. Trupi i emëruar do të kryejë auditime periodike për t'u siguruar që prodhuesi ruan dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe duhet t'i sigurojë prodhuesit një raport auditimi.

4.4. Përveç kësaj, trupi i emëruar mund të bëjë vizita të papritura të prodhuesi. Gjatë vizitave të tilla, trupi i emëruar, nëse është e nevojshme, mund të kryejë teste të produktit ose t'i bëjë ato të kryhen, për të verifikuar nëse sistemi i cilësisë po funksionon siç duhet. Trupi i emëruar duhet t'i sigurojë prodhuesit një raport vizite dhe, nëse janë kryer teste, një raport testimi.

5. Shënjimi CE, deklarata e konformitetit dhe vërtetimi i konformitetit

5.1. Prodhuesi vendos shenjën CE dhe nën përgjegjësinë e trupit të emëruar të përcaktuar në pikën 3.1, numrin e identifikimit të këtij të fundit për çdo produkt individual, përveç një komponenti që është në përputhje me llojin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të llojit dhe plotëson kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

5.2. Prodhuesi do të hartojë deklaratën e konformitetit në formë të shkruar për çdo model produkti, përveç një komponenti dhe do ta mbajë atë në dispozicion të inspektoratit kompetent për dhjetë (10) vite pasi produkti i ndryshëm nga një komponenti të jetë hedhur në treg. Deklarata e konformitetit do të bëjë identifikimin e modelit të produktit për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit do të shoqërojë çdo produkt, të ndryshëm nga komponenti.

5.3. Prodhuesi duhet të hartojë vërtetimin me shkrim të konformitetit për secilin model të komponentit dhe ta mbajë atë në dispozicion të inspektoratit kompetent për dhjetë (10) vite pasi komponenti të jetë hedhur në treg. Vërtetimi i konformitetit duhet të identifikojë modelin e komponentit për të cilin është hartuar. Një kopje e vërtetimit të konformitetit duhet të shoqërojë çdo komponent.

6. Për një periudhë që përfundon dhjetë (10) vite pasi produkti është vendosur në treg, prodhuesi do të mbajë në dispozicion të inspektoratit kompetent:

(a) dokumentacionin e përmendur në pikën 3.1,

(b) informacionin në lidhje me ndryshimin e përmendur në pikën 3.5, siç është miratuar,

(c) vendimet dhe raportet e trupit të njoftuar të përcaktuar në pikat 3.5, 4.3 dhe 4.4.

7. Çdo trup i emëruar do të informojë autoritetin emërues për miratimet e sistemit të cilësisë të lëshuara ose të tërhequra dhe në mënyrë periodike ose sipas kërkesës, do t'i vë në dispozicion autoritetit emërues listën e miratimeve të sistemit të cilësisë të refuzuara, pezulluara ose të kufizuara në ndonjë mënyrë tjetër.

Çdo trup i njoftuar do të informojë trupat tjera të emëruara për miratimet e sistemit të cilësisë të cilat i ka refuzuar, pezulluar, tërhequr ose kufizuar në ndonjë mënyrë tjetër, dhe, sipas kërkesës, për miratimet e sistemit të cilësisë që ai organ ka lëshuar.

8. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikat 3.1, 3.5, 5 dhe 6 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që ato të jenë të specifikuara në autorizim.

SHTOJCA V

MODULI F: KONFORMITETI ME LLOJIN BAZUAR NË VERIFIKIMIN E PRODUKTIT

1. Konformiteti me llojin bazuar në verifikimin e produktit është pjesa e një procedure vlerësimi të konformitetit ku prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 5 dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësinë e tij që produktet në fjalë, të cilat i janë nënshtruar dispozitave të pikës 3, janë në përputhje me llojin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të llojit dhe plotësojnë kërkesat e kësaj Rregullore të cilat zbatohen për to.

2. Prodhimi

Prodhuesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojë konformitetin e produkteve të prodhuara me llojin e miratuar të përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të llojit dhe me kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen për to.

3. Verifikimi

Një trup i emëruar i zgjedhur nga prodhuesi kryen ekzaminimet dhe testet e duhura për të kontrolluar konformitetin e produkteve me llojin e miratuar të përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të llojit dhe me kërkesat e duhura të kësaj Rregullore.

Ekzaminimet dhe testet për të kontrolluar konformitetin e produkteve me kërkesat e duhura do të kryhen me ekzaminim dhe testim të çdo produkti siç përcaktohet në pikën 4.

4. Verifikimi i konformitetit me ekzaminim dhe testim të çdo produkti

4.1. Të gjitha produktet do të ekzaminohen individualisht dhe do të kryhen testet e duhura të përcaktuara në standardin(et) e harmonizuar përkatës dhe/ose testet ekuivalente të përcaktuara në specifikimet e tjera teknike përkatëse, për të verifikuar konformitetin me llojin e miratuar të përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të llojit dhe me kërkesat e duhura të kësaj Rregullore.

Në mungesë të një standardi të tillë të harmonizuar, organi i njoftuar vendos për testet e duhura që do të kryhen.

4.2. Trupi i emëruar lëshon certifikatë konformiteti në lidhje me ekzaminimet dhe testet e kryera dhe vendosë numrin e tij të identifikimit për çdo produkt të miratuar ose do ta vendosë atë nën përgjegjësinë e tij.

Prodhuesi mban certifikatat e konformitetit në dispozicion të inspektoratit kompetent për dhjetë (10) vite pasi produkti të jetë vendosur në treg.

5. Shënjimi CE, deklarata e konformitetit dhe vërtetimi i konformitetit

5.1. Prodhuesi vendos shenjën CE dhe, nën përgjegjësinë e të emëruar të përcaktuar në pikën 3, numrin e identifikimit të këtij të fundit për çdo produkt individual, përveç një komponenti që është në përputhje me llojin e miratuar të përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të llojit dhe plotëson kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

5.2. Prodhuesi harton deklaratën e konformitetit me shkrim për çdo model produkti të ndryshëm nga një komponent dhe mbanë atë në dispozicion të inspektoratit kompetent për

dhjetë (10) vite pasi produkti të jetë vendosur në treg. Deklarata e konformitetit do të bëjë identifikimin e modelit të produktit për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit do të shoqërojë çdo produkt, të ndryshëm nga komponenti.

Nëse trupi i emëruar i përcaktuar në pikën 3, bie dakord dhe nën përgjegjësinë e tij, prodhuesi mund të vendosë gjithashtu numrin e identifikimit të trupit të emëruar në produkte të ndryshme nga komponentet.

5.3. Prodhuesi duhet të hartojë vërtetimin me shkrim të konformitetit për secilin model të komponentit dhe ta mbajë atë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për dhjetë (10) vite pasi komponenti të jetë vendposur në treg. Vërtetimi i konformitetit duhet të identifikojë modelin e komponentit për të cilin është hartuar. Një kopje e vërtetimit të konformitetit duhet të shoqërojë çdo komponent.

6. Nëse trupi i emëruar është dakord dhe nën përgjegjësinë e tij, prodhuesi mund të vendosë numrin e identifikimit të trupit të emëruar tek produktet gjatë procesit të prodhimit.

7. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që ato të jenë të specifikuara në autorizim. Përfaqësuesi i autorizuar mund të mos përmbushë detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikën 2.

SHTOJCA VI

MODULI C1: KONFORMITETI ME LLOJIN BAZUAR NË KONTROLLIN E BRENDSHËM TË PRODHIMIT PLUS TESTIMI I MBIKËQYRUR I PRODUKTIT

1. Konformiteti me llojin bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit plus testimin e mbikëqyrur të produktit është pjesë e një procedure vlerësimi të konformitetit ku prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4, dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësinë e tij që produktet në fjalë janë në përputhje me llojin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të llojit dhe plotësojnë kërkesat e kësaj Rregullore të cilat zbatohen për to.

2. Prodhimi

Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë përputhjen e produkteve të prodhuara me llojin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të llojit dhe me kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen për to.

3. Kontrollet e produktit

Për çdo produkt individual të prodhuar, një ose më shumë teste në një ose më shumë aspekte specifike të produktit do të kryhen nga prodhuesi ose në emër të tij, në mënyrë që të verifikohet konformiteti me llojin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të llojit dhe me kërkesat përkatëse të kësaj Rregullore. Testet do të kryhen nën përgjegjësinë e një trupi të emëruar, të zgjedhur nga prodhuesi.

Prodhuesi, nën përgjegjësinë e trupit të emëruar, vendos numrin e identifikimit të trupit të emëruar gjatë procesit të prodhimit.

4. Shenjimi CE, deklarata e konformitetit dhe vërtetimi i konformitetit

4.1. Prodhuesi vendosë shenjën CE në çdo produkt individual, përveç një komponenti që është në përputhje me llojin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të llojit dhe që plotëson kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

4.2. Prodhuesi harton deklaratën e konformitetit me shkrim për një model produkti të ndryshëm nga një komponent dhe do ta mbajë atë në dispozicion të inspektoriatit kompetent për dhjetë (10) vite pasi produkti, i ndryshëm nga komponenti, të jetë vendosur në treg. Deklarata e konformitetit do të identifikojë modelin e produktit për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit do të shoqërojë çdo produkt, të ndryshëm nga komponenti.

4.3. Prodhuesi harton vërtetimin me shkrim të konformitetit për secilin model të komponentit dhe ta mbajë atë në dispozicion të inspektoratit kompetent për dhjetë (100 vite pasi komponenti të jetë hedhur në treg. Vërtetimi i konformitetit duhet të identifikojë modelin e komponentit për të cilin është hartuar. Një kopje e vërtetimit të konformitetit duhet të shoqërojë çdo komponent.

5. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikën 4 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që ato të jenë të specifikuara në autorizim.

SHTOJCA VII

MODULI E: KONFORMITETI ME LLOJIT BAZUAR NË SIGURIMIN E CILËSISË SË PRODUKTIT

1. Konformiteti me llojin bazuar në sigurimin e cilësisë së produktit është pjesë e një procedure vlerësimi të konformitetit ku prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 5, dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësinë e tij që produktet në fjalë janë në përputhje me llojin të përshkruara në certifikatën e ekzaminimit të llojit dhe plotësojnë kërkesat e kësaj Rregullore të cilat zbatohen për to.

2. Prodhimi

Prodhuesi duhet të zbatojë një sistem të miratuar të cilësisë për inspektimin dhe testimin e produktit përfundimtar të produkteve në fjalë siç specifikohet në pikën 3 dhe do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes siç specifikohet në pikën 4.

3. Sistemi i cilësisë

3.1. Prodhuesi duhet të paraqesë një kërkesë për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë tek trupi i emëruar sipas zgjedhjes së tij, për produktet në fjalë.

Kërkesa duhet të përfshijë:

(a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe nëse kërkesa është paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar, emrin dhe adresën e tij gjithashtu,

(b) deklaratën me shkrim se e njëjta kërkesë nuk është depozituar në asnjë trup tjetër i emëruar,

(c) të gjithë informacionin përkatës për kategorinë e produktit të parashikuar,

(d) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë, dhe

(e) dokumentacionin teknik të tipit të miratuar dhe një kopje të certifikatës së ekzaminimit të llojit.

3.2. Sistemi i cilësisë duhet të sigurojë përputhjen e produkteve me llojin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të llojit dhe me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

Të gjithë elementët, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga prodhuesi do të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave, procedurave dhe udhëzimeve të shkruara. Dokumentacioni i sistemit të cilësisë do të lejojë një interpretim të qëndrueshëm të programeve, planeve, manualeve dhe të dhënave të cilësisë.

Dokumentacioni, në veçanti, duhet të përmbajë një përshkrim adekuat të:

(a) objektivat e cilësisë dhe strukturën organizative, përgjegjësitë dhe kompetencat e menaxhmentit në lidhje me cilësinë e produktit,

(b) ekzaminimet dhe testet që do të kryhen pas prodhimit,

(c) të dhënat e cilësisë, të tilla si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testimit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit për personelin në fjalë, etj,

(d) mjetet e monitorimit të funksionimit efektiv të sistemit të cilësisë.

3.3. Trupi i emëruar vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai plotëson kërkesat e përcaktuara në pikën 3.2.

Ai do të prezumojë konformitetin me këto kërkesa në lidhje me elementët e sistemit të cilësisë që përputhen me specifikimet përkatëse të standardit të harmonizuar relevante.

Përveç përvojës në sistemet e menaxhimit të cilësisë, ekipi i auditimit duhet të ketë të paktën një anëtar me përvojë vlerësimi në fushën përkatëse të produktit dhe teknologjinë e produktit në fjalë, dhe njohuri për kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore. Auditimi do të përfshijë një vizitë vlerësimi në ambientet e prodhuesit. Ekipi i auditimit do të shqyrtojë dokumentacionin teknik të përmendur në pikën 3.1 (e) për të verifikuar aftësinë e prodhuesit për të identifikuar kërkesat përkatëse të kësaj direktive dhe për të kryer ekzaminimet e nevojshme me qëllim që të sigurohet përputhshmëria e produktit me ato kërkesa.

Vendimi i njoftohet prodhuesit. Njoftimi përmban konkluzionet e auditimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.4. Prodhuesi do të marrë përsipër të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga sistemi i cilësisë siç është miratuar dhe ta mirëmbajë atë në mënyrë që ai të jetë në gjendje të përshtatshme dhe efikase.

3.5. Prodhuesi duhet të mbajë të informuar trupin e emëruar që ka miratuar sistemin e cilësisë për çdo ndryshim të synuar në sistemin e cilësisë.

Trupi i emëruar vlerëson çdo ndryshim të propozuar dhe vendos nëse sistemi i modifikuar i cilësisë do të vazhdojë të përmbushë kërkesat e përmendura në pikën 3.2 ose nëse është i nevojshëm një rivlerësim.

Ai do të njoftojë prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi përmban konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e trupit të emëruar

4.1. Qëllimi i mbikëqyrjes është të sigurohet që prodhuesi përmbush siç duhet detyrimet që dalin nga sistemi i miratuar i cilësisë.

4.2. Prodhuesi, për qëllime vlerësimi do t'i lejojë trupit të emëruar hyrjen në vendet e prodhimit, inspektimit, testimit dhe magazinimit dhe duhet t'i sigurojë atij të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti:

(a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë,

(b) të dhënat e cilësisë, të tilla si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testimit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit për personelin në fjalë, etj.

4.3. Trup i emëruar kryen auditime periodike për t'u siguruar që prodhuesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe duhet t'i sigurojë prodhuesit një raport auditimi.

4.4. Përveç kësaj trupi i emëruar mund të bëjë vizitë të pa paralajmërim të prodhuesi. Gjatë vizitave të tilla, trupi i emëruar nëse është e nevojshme, mund të kryejë teste të produktit ose t'i bëjë ato të kryhen, për të verifikuar nëse sistemi i cilësisë po funksionon siç duhet. Trupi i

emëruar duhet t'i sigurojë prodhuesit një raport vizite dhe një raport testimi, nëse janë kryer testime.

5. Shenjimi CE, deklarata e konformitetit dhe vërtetimi i konformitetit

5.1. Prodhuesi vendos shenjën CE dhe nën përgjegjësinë e trupit të emëruar të përcaktuar në pikën 3.1, numrin e identifikimit të këtij të fundit për çdo produkt individual, të ndryshëm nga një komponent që është në përputhje me llojin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të llojit dhe plotëson kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

5.2. Prodhuesi harton deklaratën me shkrim të konformitetit për çdo model produkti, të ndryshëm nga një komponenti dhe do ta mbajë atë në dispozicion të inspektoratit kompetent për dhjetë (10) vite pasi produkti i ndryshëm nga komponenti të jetë vendosur në treg. Deklarata e konformitetit do të identifikojë modelin e produktit për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit do të shoqërojë çdo produkt, të ndryshëm nga komponenti.

5.3. Prodhuesi duhet të hartojë një vërtetim me shkrim të konformitetit për secilin model të komponentit dhe ta mbajë atë në dispozicion të inspektoratit kompetent për 10 vite pasi komponenti të jetë vendosur në treg. Vërtetimi i konformitetit duhet të identifikojë modelin e komponentit për të cilin është hartuar. Një kopje e vërtetimit të konformitetit duhet të shoqërojë çdo komponent.

6. Prodhuesi, për një periudhë që përfundon dhjetë (10) vite pasi produkti është hedhur në treg, do të mbajë në dispozicion të inspektoratit kompetent:

(a) dokumentacionin e përmendur në pikën 3.1,

(b) informacionin në lidhje me ndryshimin e përmendur në pikën 3.5, siç është miratuar,

(c) vendimet dhe raportet e trupi i emëruar të përcaktuar në pikat 3.5, 4.3 dhe 4.4.

7. Çdo trup i emëruar do të informojë autoritetin e tij emërues për miratimet e sistemit të cilësisë të lëshuara ose të tërhequra dhe, në mënyrë periodike ose sipas kërkesës, do t'i vërë në dispozicion autoritetit të tij emërues listën e miratimeve të sistemit të cilësisë të refuzuara, pezulluara ose të kufizuara në ndonjë mënyrë tjetër.

Çdo trup i emëruar do të informojë trupat e tjera të emëruara për miratimet e sistemit të cilësisë që ai ka refuzuar, pezulluar ose tërhequr, dhe, sipas kërkesës, për miratimet e sistemit të cilësisë që ai ka lëshuar.

8. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikat 3.1, 3.5, 5 dhe 6 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që ato të jenë të specifikuara në autorizim.

SHTOJCA VIII

MODULI A: KONTROLLI I BRENDSHËM I PRODHIMIT

1. Kontrolli i brendshëm i prodhimit është procedura e vlerësimit të konformitetit ku prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4, dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësinë e tij që produktet në fjalë plotësojnë kërkesat e kësaj Rregullore të cilat zbatohen për to.

2. Dokumentacioni teknik

Prodhuesi harton dokumentacionin teknik. Dokumentacioni bënë të mundur vlerësimin e përputhshmërisë së produktit me kërkesat përkatëse dhe përfshinë një analizë dhe vlerësim adekuat të rrezikut(qeve).

Dokumentacioni teknik specifikon kërkesat e zbatueshme dhe mbulon për aq sa është e rëndësishme për vlerësimin, projektimin, prodhimin dhe funksionimin e produktit. Dokumentacioni teknik përmban të paktën elementet e mëposhtme:

(a) një përshkrim të përgjithshëm të produktit,

(b) vizatimet dhe skemat konceptuale të dizajnit dhe prodhimit të komponentëve, nën-montazheve, qarqeve, etj.

(c) përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për të kuptuar ato vizatime dhe skema dhe funksionimin e produktit,

(d) listën të standardeve të harmonizuara të zbatuara plotësisht ose pjesërisht, referencat e të cilave janë botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe kur ato standarde të harmonizuara nuk janë zbatuar, përshkrimet e zgjidhjeve të miratuara për të përmbushur kërkesat themelore, kërkesat e shëndetit dhe sigurisë sipas kësaj Rregullore, duke përfshirë një listë të specifikimeve të tjera teknike përkatëse të aplikuara. Në rast të standardeve të harmonizuara pjesërisht të zbatuara, dokumentacioni teknik specifikon pjesët që janë zbatuar,

(e) rezultatet e llogaritjeve të kryera të dizajnit, ekzaminimet e kryera, etj, dhe

(f) raportet e testimit.

3. Prodhimi

Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojë përputhjen e produkteve të prodhuara me dokumentacionin teknik të përcaktuar në pikën 2 dhe me kërkesat e kësaj Rregullore të cilat zbatohen për to.

4. Shënjimi CE, deklarata e konformitetit dhe vërtetimi i konformitetit

4.1. Prodhuesi duhet të vendosë shenjën CE për çdo produkt individual, të ndryshëm nga një komponent që plotëson kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

4.2. Prodhuesi harton deklaratën e konformitetit me shkrim për një model produkti të ndryshëm nga një komponent dhe mbanë atë së bashku me dokumentacionin teknik në dispozicion të inspektoratit kompetent për dhjetë (10) vite pasi produkti i ndryshëm nga komponenti të jetë vendosur në tregu. Deklarata e konformitetit identifikon modelin e produktit për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit shoqëron çdo produkt, të ndryshëm nga komponenti.

4.3. Prodhuesi harton me shkrim vërtetimin konformitetit për secilin model të komponentit dhe mban atë së bashku me dokumentacionin teknik në dispozicion të inspektoratit kompetent për dhjetë 10 vite pasi komponenti të jetë hedhur në treg. Vërtetimi i konformitetit duhet të identifikojë komponentin për të cilin është hartuar. Një kopje e vërtetimit të konformitetit duhet të shoqërojë çdo komponent.

5. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikën 4 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që ato të jenë të specifikuara në autorizim.

SHTOJCA IX

MODULI G: KONFORMITETI I BAZUAR NË VERIFIKIMIN E NJËSISË

1. Konformiteti i bazuar në verifikimin e njësisë është procedura e vlerësimit të konformitetit ku prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 5 dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësinë e tij që produkti në fjalë, i cili i është nënshtruar dispozitave të pikës 4, është në përputhje me kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen për të.

2. Dokumentacioni teknik

2.1. Prodhuesi harton dokumentacionin teknik dhe vë në dispozicion të trupit të emëruar të përcaktuar në pikën 4. Dokumentacioni bënë të mundur vlerësimin e konformitetit të produktit me kërkesat përkatëse dhe duhet të përfshijë një analizë dhe vlerësim adekuat të rrezikut(qeve). Dokumentacioni teknik do të specifikojë kërkesat e zbatueshme dhe do të mbulojë, për aq sa është e rëndësishme për vlerësimin, projektimin, prodhimin dhe funksionimin e produktit. Dokumentacioni teknik përmban të paktën elementet e mëposhtme:

(a) një përshkrim të përgjithshëm të produktit,

(b) vizatimet dhe skemat konceptuale të dizajnit dhe prodhimit të komponentëve, nën-montazheve, qarqeve, etj.

(c) përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për të kuptuar ato vizatime dhe skema dhe funksionimin e produktit,

(d) një listë të standardeve të harmonizuara të zbatuara plotësisht ose pjesërisht, referencat e të cilave janë botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe, kur ato standarde të harmonizuara nuk janë zbatuar, përshkrimet e zgjidhjeve të miratuara për të përmbushur kërkesat themelore, kërkesat e shëndetit dhe sigurisë sipas kësaj Rregullore, duke përfshirë listën e specifikimeve të tjera teknike përkatëse të aplikuara. Në rast të standardeve të harmonizuara pjesërisht të zbatuara, dokumentacioni teknik specifikon pjesët që janë zbatuar,

(e) rezultatet e llogaritjeve të kryera të dizajnit, ekzaminimet e kryera, etj, dhe

(f) raportet e testimit.

2.2. Prodhuesi mban dokumentacionin teknik në dispozicion të inspektoratit kompetent për dhjetë (10) vite pasi produkti të jetë vendosur në treg.

3. Prodhimi

Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë konformitetin e produktit të prodhuar me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

4. Verifikimi

Trupi i emëruar i zgjedhur nga prodhuesi kryen ekzaminimet dhe testet e duhura, të përcaktuara në standardet përkatëse të harmonizuara dhe/ose testet ekuivalente të përcaktuara në specifikimet e tjera teknike përkatëse, për të kontrolluar konformitetin e produktit me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore. Në mungesë të një standardi të tillë të harmonizuar, organi i njoftuar në fjalë do të vendosë për testet e duhura të cilat do të kryhen.

Trupi i emëruar lëshon certifikatën e konformitetit në lidhje me ekzaminimet dhe testet e kryera dhe vendosë numrin e tij të identifikimit në produktin e miratuar, ose vendosë atë nën përgjegjësinë e tij.

Prodhuesi mban certifikatat e konformitetit në dispozicion të inspektoratit kompetent për dhjetë (10) vite pasi produkti të jetë vendosur në treg.

5. Shënjimi CE, deklarata e konformitetit dhe vërtetimi i konformitetit

5.1. Prodhuesi vendos shenjën CE dhe nën përgjegjësinë e trupit të emëruar të përcaktuar në pikën 4, numrin e identifikimit të këtij të fundit për çdo produkt, të ndryshëm nga një komponent që plotëson kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

5.2. Prodhuesi harton deklaratën e konformitetit me shkrim dhe mban atë në dispozicion të inspektoratit kompetent për dhjetë (10) vite pasi produkti i ndryshëm nga komponenti të jetë vendosur në treg. Deklarata e konformitetit identifikon produktin për të cilin është hartuar.

Kopja e deklaratës së konformitetit shoqëron çdo produkt, të ndryshëm nga komponenti.

5.3. Prodhuesi harton vërtetimin me shkrim të konformitetit dhe mban atë në dispozicion të inspektoratit kompetent për dhjetë 10 vite pasi komponenti të jetë vendosur në treg. Vërtetimi i konformitetit identifikon komponentin për të cilin është hartuar. Kopja e vërtetimit të konformitetit shoqëron çdo komponent.

6. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikat 2.2 dhe 5 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që ato të jenë të specifikuara në autorizim.

SHTOJCA X

DEKLARATA E KONFORMITETIT (Nr. XXXX) ([1])

1. Modeli i produktit /produkti (produkti, lloji, seria ose numri serik):

2. Emri dhe adresa e prodhuesit dhe varësisht nga rasti, përfaqësuesit të tij të autorizuar:

3. Deklarata konformitetit lëshohet vetëm nën përgjegjësinë e prodhuesit.

4. Objekti i deklaratës (identifikimi i produktit që lejon gjurmimin; kurdo që është e nevojshme për identifikimin e produktit, mund të përfshihet një imazh i tij):

5. Objekti i deklaratës së përshkruar më sipër është në përputhje me legjislacionin përkatës të harmonizuar të Republikës së Kosovës:

6. Referencat në standardet përkatëse të harmonizuara të përdorura ose referenca në specifikimet e tjera teknike në lidhje me të cilat deklarohet konformiteti:

7. Kur është e aplikueshme, trupi i emëruar … (emri, numri) ka kryer … (përshkrimin e ndërhyrjes) dhe ka lëshuar certifikatën:

8. Informata shtesë:

Nënshkruar për dhe në emër të: (vendi dhe data e lëshimit):

(emri, funksioni) (nënshkrimi):

[1] Është opsionale që prodhuesi t'i caktojë një numër deklaratës së konformitetit.

PRILOG I

KRITERIJUMI ZA UTVRĐIVANJE KLASIFIKACIJE GRUPA OPREMA U KATEGORIJI

1. Oprema grupe I

(a) Kategorija opreme M 1 uključuje opreme dizajnirane i, kada je potrebno, opremljene posebnim dodatnim sredstvima zaštite da bi funkcionirali u usaglašenost sa radnim parametrima postavljenih od proizvođača i obezbediti vrlo visok nivo zaštite.

Opreme ove kategorije su namenjene za korišćenje u podzemnim delovima rudnika, kao i onim delovima površinskih instalacija takvih rudnika ugroženih od eksplozivnog gasa i/ili zapaljivom prašinom.

Zahteva se da oprema ove kategorije ostane funkcionalna, i u slučaju retkih incidenata koji se vežu sa opremama, sa prisutnom eksplozivnom atmosferom, i karakteriziraju se od zaštitnih sredstava takva da:

- bilo da, u slučaju neuspeha/kvara jednog sredstva zaštite, najmanje drugo nezavisno sredstvo obezbeđuje potreban nivo zaštite,
- ili potreban nivo zaštite obezbeđuje se u slučaju da se dva kvara dese na nezavisan način jedan od drugog.

Opreme ove kategorije treba da budu u skladu sa dodatnim zahtevima referisanim u tačku 2.0.1 Priloga II.

(b) Kategorija opreme M 2 uključuje opreme dizajnirane da budu u stanju da funkcionišu u usaglašenosti sa operativnim parametrima postavljenih od proizvođača i obezbedivši vrlo visok nivo zaštite.

Oprema ove kategorije je namenjena za korišćenje u podzemnim delovima rudnika, kao i onim delovima površinskih instalacija takvih rudnika koji se mogu ugroziti od eksplozivnog gasa i/ili zapaljivom prašinom.

U slučaju eksplozivne atmosfere, treba biti moguće prekinuti snabdevanje sa električnom energijom za ovu opremu.

Sredstva zaštite u vezi sa opremama ove kategorije obezbeđuju potreban nivo zaštite tokom normalnog funkcionisanja i takođe u slučaju težih uslova funkcionisanja, posebno onih koji proizilaze od grubog tretmana i promene uslova životne sredine.

Opreme ove kategorije treba da budu u skladu sa dodatnim zahtevima referisane u tačku 2.0.2 Priloga II.

2. Oprema-grupa II

(a) Kategorija 1 opreme uključuje opreme dizajnirane da bi bile u stanju funkcionisati u usaglašenost sa operativnim parametrima stavljenih od proizvođača i obezbedivši vrlo visokog nivo zaštite.

Opreme ove kategorije su namenjene za korišćenje u područja gde su eksplozivne atmosfere uzrokovane od mešavina vazduha i gasova, para ili maglom ili od mešavina vazduha/ prašine prisutne kontinuirano, za duge periode ili što se dešavaju vrlo često.

Opreme ove kategorije treba da obezbede potreban nivo zaštite, i u slučaju retkih incidenata koji se vežu sa opremama, i karakterizuju od sredstva zaštite takva koja:

- bilo da, u slučaju neuspeha/kvara jednog sredstva zaštite, najmanje drugo nezavisno sredstvo obezbeđuje potreban nivo zaštite,
- ili potreban nivo zaštite obezbeđuje se u slučaju da se dva kvara dese na nezavisan način jedan od drugog.

Opreme ove kategorije treba da budu u skladu sa dodatnim zahtevima referisanim u tačku 2.1 Priloga II.

(b) Kategorija 2 opreme uključuje opreme dizajnirane da budu u stanju da funkcionišu u skladu sa operativnim parametrima postavljenih od proizvođača i obezbediti visok nivo zaštite.

Opreme ove kategorije su namenjene za korišćenje u područja gde eksplozivne atmosfere uzrokovane od gasova, para, magli ili mešavinama vazduha/prašine postoji verovatnoća da nastanu povremeno.

Sredstva zaštite u vezi sa opremama ove kategorije obezbeđuju odgovarajući nivo zaštite, koji se normalno trebaju uzeti u obzir i u slučaju neuspeha i kvarova opreme koji se često dešavaju.

Oprema ove kategorije treba da budu u skladu sa dodatnim zahtevima referisani u tačku 2.2 Priloga II.

(c) Kategorija 3 opreme uključuje opreme dizajnirane da budu u stanju da funkcionišu u skladu sa parametrima funkcionisanja utvrđenim od proizvođača i obezbediti normalan nivo zaštite.

Oprema ove kategorije su namenjene za korišćenje u područja u kojima eksplozivne atmosfere uzrokovane od gasova, para, maglom ili mešavina vazduha/prašine nema verovatnoće da se dese ili, ako se dese, verovatno će se desiti retko i samo za kratak period.

Opreme ove kategorije obezbeđuju potreban nivo zaštite tokom normalnog funkcionisanja.

Opreme ove kategorije treba da budu u skladu sa dodatnim zahtevima referisani u tačku 2.3 Priloga II.

PRILOG II

OSNOVNI ZAHTEVI ZDRAVLJA I BEZBEDNOSTI KOJI SE ODNOSE NA PROJEKTOVANJE I IZGRADNJU OPREMI I ZAŠTITNIH SISTEMA NAMENJENIM ZA UPOTREBU U POTENCIJALNO EKSPLOZIVNIM ATMOSFERAMA

Prethodna posmatranja

A. Tehnološka znanja, koja se mogu brzo menjati, trebaju se uzeti u obzir što je pre moguće i da se odmah sprovedu.

B. Za sredstva specifikovana u članu 2 stav 1, pod stav 1.2 ove Uredbe, osnovni zahtevi će se sprovoditi samo u meri koliko je potrebno za bezbedno i pouzdano funkcionisanje ovih oprema u vezi sa opasnostima eksplozije.

Zajednički zahtevi o opremi i zaštitnim sistemima

1.0. Opšti zahtevi.

1.0.1. principi integrisane bezbednosti eksplozije

